



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, më 12 shtator, Trupi Gjyqësor hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes së Selimit për redaktim të disa provave në deklaratën e mëparshme të një dëshmitari, kur ajo t'i paraqitet atij gjatë seancës përgatitore për dhënie të dëshmisë. Mbrojtja kishte argumentuar se provat përkatëse nuk ishin në listën e provave materiale. Mbrojtja e Selimit më tej kërkoi nga Trupi Gjyqësor të paralajmëronte Prokurorinë të mos ndikonte në dëshmitarin gjatë seancës përgatitore.

Trupi Gjyqësor kujtoi se ligji kërkon që gjatë një seance përgatitore, avokati që parashtron pyetje duhet t'i japë dëshmitarit mundësinë për rishikim të deklaratave të mëparshme, edhe kur pjesë të tyre nuk kanë të bëjnë me dëshminë që do të japë. Kjo bëhet për t'u siguruar dëshmitarëve mundësi të arsyeshme për t'u njohur me deklaratat e tyre të mëparshme para se të fillojnë dhënien e dëshmisë.

Trupi Gjyqësor konstatoi gjithashtu se duke pasur parasysh se kishte përjashtuar një pjesë të madhe të provave të propozuara të dëshmitarit, ishte e arsyeshme që Prokuroria t'i shpjegonte dëshmitarit se kishte ende prova të rëndësishme që ai lejohej të jepte. Trupi Gjyqësor përfundoi se kjo u bë në një mënyrë që nuk ishte e paarsyeshme ose e padrejtë.

Më 13 shtator, Trupi Gjyqësor miratoi kërkesën e Prokurorisë që lejoi dhënien e dëshmisë së një dëshmitari nëpërmjet videolidhjes. Bazuar në rekomandimet e Zyrës Administrative, Trupi Gjyqësor urdhëroi më tej modifikimin e orarit të seancës në mënyrë që dëshmitari të fillonte dhënien e dëshmisë në orën 12 ditën e parë dhe në orën 11, në ditët në vijim. Për të përdorur kohën në sallë të gjyqit me efikasitet, Trupi Gjyqësor urdhëroi Prokurorinë të përpiqej të caktonte dëshmitarë rezervë për dhënie të dëshmisë midis orës 9:00 dhe 10:30 paradite.

Më 13 shtator, Trupi Gjyqësor miratoi një kërkesë të Prokurorisë, ku konstatoi se pranimi si prova i deklaratave dhe provave materiale shoqëruese të 12 dëshmitarëve ishte i përshtatshëm pasi ata të jenë paraqitur në gjykatë.

Gjithashtu më 13 shtator, Trupi Gjyqësor urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit. Trupi Gjyqësor konstatoi se për të dy të akuzuarit vazhdon të ekzistojë rreziku se ata do të pengojnë ecurinë e procesit dhe/ose të kryejnë vepra penale të tjera kundër atyre që konsiderohen se janë kundër UÇK-së, përfshirë dëshmitarë të cilët kanë dhënë dëshmi në çështjen gjyqësore dhe/ose pritet të paraqiten para Dhomave të Specializuara. Trupi Gjyqësor rikujtoi atmosferën e vazhdueshme të frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë dhe theksoi se duket se z. Selimi nxori informacion të privilegjuar për palë të treta





të paautorizuara. Trupi Gjykses përfundoi se komunikimet e të akuzuarve mund të kufizohen në një mënyrë që zvogëlon mjaftueshëm këto rreziqe vetëm me anë të zbatimit të kornizës për monitorimin e komunikimeve që përdoret në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara.

Gjatë kësaj jave dhanë dëshmi katër dëshmitarë të thirrur nga Prokuroria. Sipas përmbledhjes së Prokurorisë, dëshmitari i parë ishte anëtar i UÇK-së në zonën operative të Pashtrikut. Dëshmia e dëshmitarit u dha kryesisht në seancë private. Dëshmitari i dytë dha dëshmi nëpërmjet videolidhjes dhe me masa mbrojtëse dhe foli për rrëmbimin nga anëtarë të armatosur të UÇK-së në Fushë Kosovë nga mesi i qershorit 1999 dhe më pas mbajtjen në ndalim në vende të ndryshme. Sot paradite, dëshmitari i 87-të filloi dhënien e dëshmisë, gjithashtu nëpërmjet videolidhjes. Sipas Prokurorisë dëshmitari, Halim Berisha, në prill 1999 shoqëroi një person në kompleksin e ndalimit në Zllash dhe më vonë mësoi se personi kishte vdekur. Sot pasdite një dëshmitar tjetër i mbrojtur filloi dhënien e dëshmisë përmes videolidhjes, lidhur me arrestimin nga disa anëtarë të UÇK-së në vitin 1999 dhe ndalimin në fabrikën e metalit në Kukës, Shqipëri.

Gjykatësit mund të urdhërojnë masa mbrojtëse rast pas rasti, në pjesën më të madhe për të mbrojtur identitetet e viktimave dhe dëshmitarëve. Megjithatë, edhe pse dhënia e dëshmisë është e mbyllur për publikun, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre mund të dëgjojnë dhe shohin dëshmitarin.

Seanca e ardhshme në këtë çështje gjyqësore është caktuar për të hënë, 23 shtator 2024, dhe fillon në orën 9 paradite.

Në çështjen gjyqësore të Pjetër Shalës, konferenca para apelit është caktuar për nesër, 20 shtator. Gjatë seancës, palët pritët të paraqesin parashtrime dhe Trupi Gjykses do të kërkojë përditësime lidhur me ecurinë e përkthimit në shqipe të Aktgjykimit. Administratorja kishte informuar se versioni jopërfundimtar i përkthimit do të dorëzohej më 6 shtator dhe versioni përfundimtar në fund të tetorit. Dhomat e Specializuara përkthejnë të gjitha dokumentet dhe parashtrimet e protokolluara publike në të tri gjuhët e gjykatës, shqipe, serbishte dhe anglishte sa më shpejtë që është e mundshme.

Gjatë kësaj jave, ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim i Dhomave të Specializuara u takua me studentë universiteti dhe nxënës të shkollës së mesme në Prishtinë dhe Ferizaj dhe me pjesëtarë të pakicave në Lapllasellë. Gjatë këtyre takimeve, ekipi diskutoi mandatin dhe proceset gjyqësore të gjykatës me publikun përkatës. Ata gjithashtu zhvilluan një tryezë të rrumbullakët me gazetarë në Prishtinë për t'u dhënë atyre informacion të përditësuar lidhur me gjykimet dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre.

